

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kontrabandë nga Greqia me autobus, arrestohen dy 43-vjeçarë në Gjirokastrë! U kapën me 22 mijë eur o, 100 steka cigare dhe mallra të fshehura - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/kontrabande-nga-greqia-me-autobus-arrestohen-dy-43vjecare-ne-gjirokaster-u-kapen-me-22-mije-euro-100-steka-cigare-dhe-mallra-te-fshehura
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 08:40:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 08:34:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4ed743f3dc8f52a6b6df91b8f09abc2139a773d372ddb1733350cac7922c7435
TEKSTI	f805d47af413b01676dcfb3c0f96c976fe2bacedd2934b8c7e204311e27f9a68
PAMJA	c892af9ea6c840f3e5eb5969790d5dbfb76fe2aad62a719b5d94112c8d66fbf6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cb2627024174a017560c74a93c6c89ab7c1ea1f9772370af68d72e1ea3e35fbc
E MËPARSHMJA	44be38188076732c4fad729c19a16c69e289f9f69e4f7bd9a7da2690903b0642
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cb2627024174a017560c74a93c6c89ab7c1ea1f9772370af68d72e1ea3e35fbc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Flash

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Vizita në SHBA, Rama me diasporën në Michigan: S'jemi më vend mbijetese, por shprese! Objektivi ynë, BE në 2030! Kryeministri merr dedikimin e veçantë

Kronikë

Kontrabandë nga Greqia me autobus, arrestohen dy 43-vjeçarë në Gjirokastrë! U kapën me 22 mijë euro, 100 steka cigare dhe mallra të fshehura

Gjatë kontrollit në autobus janë gjetur të fshehura, në vende të mbyllura, 100 steka me cigare dhe 22 695 euro, si dhe, në bagazh, janë gjetur kuti me produkte të ndryshme deti dhe mishi, produkte bulmeti, kuti me medikamente dhe 13 thasë me veshje të markave të ndryshme,



Steka cigare kontrabandë

GJIROKASTËR



Redaksia

20 Shtator, 10:32 | Përditësimi: 20 Shtator, 10:36

f Share Tweet



Dy 43-vjeçarë nga Tirana janë arrestuar në aksin [Kakavijë-Gjirokastrë](#), pasi u kapën duke transportuar me autobus mallra të kontrabanduara nga Greqia.

Gjatë kontrollit, policia gjeti të fshehura 22 695 euro dhe 100 steka cigare, ndërsa në bagazh u zbuluan produkte ushqimore, medikamente dhe 13 thasë me veshje të markave të ndryshme.

Në kuadër të operacionit të koduar "Akciza 3", u sekuestruan mallrat, autobusi dhe një telefon celular.



LEXO EDHE:

Zjarr pranë fshatit 'Arshi Lengo' të Gjirokastrës, flakët ju afrohen banesave! Një vatër aktive edhe pranë varrezave në Babicë të Vlorës

"Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare, pas informacioneve të marra nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore Rajonale Vlorë-Gjirokastrë, në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e kontrabandës së mallrave, goditën një rast të kontrabandimit të mallrave nga Greqia.

Për këtë rast u vunë në pranga shtetasit O. L., 43 vjeç, dhe M. D., 43 vjeç, të dy banues në Tiranë, për veprat penale "Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara", "Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të

akcizes, "kontrabanda me mallra të tjera", "rregtimi dhe transportimi i mallrave që janë **kontrabande**", "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".

Në aksin rrugor "Kakavijë-Gjirokastrë", shërbimet e Policisë kanë ndaluar autobusin që këta shtetas e drejtonin me radhë. Gjatë kontrollit në autobus janë gjetur të fshehura, në vende të mbyllura, 100 steka me cigare dhe 22 695 euro, si dhe, në bagazh, janë gjetur kuti me produkte të ndryshme deti dhe mishi, produkte bulmeti, kuti me medikamente dhe 13 thasë me veshje të markave të ndryshme, si dhe mallra të tjera, të cilat dyshohet se këta shtetas i kanë kontrabanduar nga Greqia.

Mallrat, autobusi dhe 1 aparat celular u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Vijon puna hetimore për dokumentimin e plotë të rastit dhe për identifikimin e personave të tjerë të dyshuar të implikuar në këtë veprimtari kriminale", njofton Policia.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë\

U.D/Shqiptarja.com

TAG: [kontrabande](#) [kakavije](#) [Gjirokastrë](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ 5.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

16 Shtator, 14:18

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Polemikat për manekinin e Çerçiz Topullit, jep dorëheqjen kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë

19 Shtator, 11:53



Veshjet dhe armët e Çerçiz Topullit ekspozohen në Kalanë e Gjirokastrës, portreti i heroit në manekin ngjall kritika: Hiqeni këtë dordolec!

18 Shtator, 20:24



'Eliani i vogël pret mësuesen te rruga e malit', drejt mbylljes shkolla me histori 82-vjeçare në Seničan të Këlcyrës! Sot kanë mbetur vetëm 3 nxënës



Piro Nase

16 Shtator, 15:01



Bie numri i nxënësve në disa qytete, shkollat e fshatrave drejt mbylljes! Surprizon Lushnja, regjistron afro 300 nxënës më shumë se vjet

14 Shtator, 16:29



'Territorialja', Rama takim në Gjirokastrë: Qëllimi i reformës, për të pasur një përqëndrim më racional të disa funksioneve që nuk i bëjnë dot bashkitë e vogla (VIDEO)

12 Shtator, 18:38



Rriten regjistrimet në Universitetin e Gjirokastrës, 300 studentë në fazën e parë, interesi i lartë për infermierinë dhe ekonomikun



Piro Nase



Kakavijë/ 'Menu'
kontrabandë,
sekuestrohen 685 kg
bërxolla viçi dhe 83 kg
peshk në autobusët nga
Athina drejt Shqipërisë

9 Shtator, 21:51



U dënua nga regjimi
komunist për sabotim të
ekonomisë, vendoset
busti i ish-ministrit Vasil
Kati në Labovë të Kryqit



Piro Nase

9 Shtator, 16:35



Çelet muzeu i ri në
Gjirokastrë/ Me gjatësi
800 metra dhe 59 dhoma,
ky është tuneli
antibërthamor ku do
"strehohet" byroja e
komunizmit



Piro Nase

8 Shtator, 16:35



Pamje nga puna për
rilindjen e Manastirit të
Kryeengjëjve në
Dervican, Rama: Thesar i
çmuar i Dropullit (VIDEO)

5 Shtator, 09:25



Zjarr në Picar të
Gjirokastrës, flakët
rezikojnë të përhapen
drejt banesave të fshatit!
2 grupe zjarrfikëse në
teren (VIDEO)

4 Shtator, 21:11



Në thellësitë e Ujit të Zi,
ekipi i zhytësve polakë
eksploron 1.5 km të
burimit të Këlcyrës:
Rrjedha ndryshoi drejtim,
mund të lidhet me një
shpellë tjetër

4 Shtator, 08:28

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kësaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.